



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.126/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Mitrovicë, paraqitur kundër subjektit politik Alternativa dega në Mitrovicë, për shkak të vendosjes së banerit mbi rrugë publike të kandidatit të tyre për Kryetar të Komunës së Mitrovicës, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 06.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Mitrovicë, dhe subjektit politik Alternativa dega në Mitrovicë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 600.00 (gjashtëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datën 05.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 03.10.2017 nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Mitrovicë me të cilën pretendon se me datën 02.10.2017 në Mitrovicë në rrugën “Shemsi Ahmeti” dhe në disa rrugë tjera të qytetit të Mitrovicës aktivistet e subjektit politik Alternativa kanë vendosur pllakata të kandidatit për kryetar të komunës së Mitrovicës Mehmet Mehmeti veprime këto të cilat sipas parashtruesit të ankesës janë në kundërshtim me nenin 33 par 1 pika b) të LZP-së. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 06.10.2017, subjekti politik Alternativa dega në Mitrovicë thekson se ka ndërmar masat përmisuese duke e evituar shlejen dhe duke e larguar banerin nga vendi ku ka qenë i vendosur.

Si dëshmi ka bashkangjitur fotografit me të cilat shihet se është larguar baneri nga vendi ku ka qenë i vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri reklamues i kandidatit për kryetar të Komunës së Mitrovicës nga subjekti politik Alternativa është vendosur mbi rrugë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave, njoftimeve dhe sloganeve në lidhje me fushatën, në apo mbi rrugë publike.*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Alternativa, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që baneri i kandidatit për kryetar komune nga ky subjekt politik, është vendosur mbi rrugë publike

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Alternativa, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thot se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti baneri reklamues i kandidatit nga subjekti politik Alternativa është vendosur mbi rrugë publike. Poashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se subjektit politik në fjalë ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarr veprime për të bërë përmisimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr banerin nga vendi i palejuar ku ka qenë i vendosur ai, i cili veprim ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL. Anr.126/2017 më datën 06.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.